



BASHKIMI I SINDIKATAVE TË PAVARURA TË KOSOVËS
THE UNION OF INDEPENDENT TRADE UNIONS OF KOSOVA

Adresa: Rr. "Nëna Terezë" 35, 10 000 PRISHTINË,
Tel/fax: ++381(0)38 229 838, e-mail: bspk@etuc.org



Gjykata Kushtetuese vendos në favor të kërkesës së punëtorëve të Fabrikës së Tubave

Prishtinë, 23 dhjetor -Pas një sërë procesesh gjyqësore, duke filluar që nga Gjykata Komunale e Ferizajt, më 2001 e deri tek ajo Kushtetuese, punëtorët e Fabrikës së Tubave, kanë arritur që në mënyrë ligjore, të fitojnë të drejtën e tyre. Atyre u është njohur e drejta për kompensim të mjeteve materiale financiare, për kohën e largimit të tyre të dhunshëm nga fabrika, nga forcat serbe që nga viti 1990. Kryetari i Shoqatës Sindikale të kësaj Fabrike, Ali Azemi, pohoi se sipas vendimit të Gjykatës Komunale të Ferizajt i njohur edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës, punëtorëve u është njohur e drejta edhe në asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, andaj nëse Qeveria dhe AKP-ja nuk i paguajnë paratë sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, Fabrika e Tubave do të bëhet pronë e tyre. Ky vendim i Gjykatës Kushtetuese, njeh të drejtën e kompensimit të punëtorëve në shumën prej 25.649.250.00 euro, ndërsa kësaj shume po t'i shtoheshin edhe kamatat dilte që shuma arrin mbi 30 milion euro, që Qeveria e Kosovës dhe AKP-ja duhet të paguajnë në xhirollogaritë e punëtorëve. Ky problem ka kaluar nëpër shumë seanca gjyqësore, është përcjellë edhe me protesta të shumta të punëtorëve dhe është parë si i pamundshëm që të zgjidhej, për faktin se shuma e pretenduar ishte shumë e lartë. Sindikalisti Azemi, tha që së shpejti do të kontaktojë me zyrat e Qeverisë së Kosovës dhe me AKP-në, për të parë se si do të hidhen hapat e radhës për të realizuar këtë të drejtë të punëtorëve. Së shpejti do të tubohen, punëtorët e Fabrikës së Tubave, për t'u njoftuar me këtë vendim si dhe për të diskutuar për hapat e mëtejshëm. Aktualisht në Fabrikën e Tubave janë të punësuar mbi 300 punëtorë, ndërsa sipas Azemit vetëm 100 prej tyre janë ish-punëtorë të Fabrikës. Po qe se ky vendim jetësohet në një apo formë tjetër, afro një mijë punëtorë, do të merrnin nga 20 mijë euro e më shumë.

Zyra për Informim, BSPK

Fatma Rastelica

Kryetari i BSPK-së

Haxhi Arifi